



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11216 Prot

Lezhë, më 14 / 06 /2022

VENDIM

Nr. 55, Datë 13 . 06 .2022

PËR

DISA SHITESA E NDRYSHIME NE VKB NR.157, DATË 17.11.2021  
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR  
SHËRBIET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT FISKALE,  
STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SË PENALITETEVE  
NDAJ KUNDRAVAJTËSVE

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Të japë Amnistinë për Penalitetet e vendosura ndaj bizneseve për shfrytëzimin e hapësirave publike në periudhën 01.06.2021 – 31.12.2021 “Për kategorinë “Biznes” dhe ky detyrim do të zerohet. Të gjitha subjekteve që kanë bërë likuidimin e këtij Penaliteti dhe plotësojnë kriteret e paracaktuara për të përfituar nga kjo Amnisti, vlera e likuiduar do t’u konsiderohet si kredit për shlyerjen e Taksave sipas Njoftimeve të Detyrimit të dorezuara bazuar në Paketën Fiskale të miratuar për vitin aktual.
2. Të bëjë ndryshim të pikës B.3.8 “Tarifa e parkimit të automjeteve”, si më poshtë :
  - a. **Ishte :** “E drejta për kërkesë për leje”, fjalia e parë “ Subjektet e biznesit të vogël mund të bëjnë kërkesë për t’u pajisur me Leje Shfrytëzimi Hapësire Publike për qëllime parkimi të rezervuar vetëm për një vendparkim, ndërsa subjektet e biznesit të madh, jo më shumë se dy vende parkimi”.
  - b. **Bëhet:** Për paisjen me leje për parkim të rezervuar të mos ketë kufizime në numrin e vendeve të parkimit. Çdo biznes mund të marrë vende parkimi pakufizim, nëse

krijohen kushtet sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk pengohet lëvizja e lirë e makinave dhe qytetarëve.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

